

UDHËZIM
Nr. 21, datë 8.8.2014

PËR RRRITJEN E NDJEKJES SË ARSIMIT PARASHKOLLOR NGA FËMIJËT ROMË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 21, të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

I. Në zbatim të nismës “Çdo fëmijë rom në kopsht”, kopshtet dhe shkollat që kanë në varësi kopshte, të marrin masa për ndjekjen e kopshtit nga fëmijët romë. Për këtë:

1. Drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore:

a) Të hartojnë një plan veprimi për rritjen e ndjekjes së kopshtit dhe integrimin e fëmijëve romë në kopshte për vitin shkollor 2014-2015. Plani i veprimit të përmbajë: objektiva të matshëm, statistikata e komunitetit rom, të dhënat për fëmijët romë 3-6 vjeç, si dhe tregues progresi, që do të jenë të njëjtë për të gjitha DAR-ZA-të dhe do t’u dërgohen nga MAS-i.

b) Të raportojnë në Drejtoritë e Arsimit Parauniversitar në MAS treguesit e progresit (në fund të muajve tetor, janar dhe qershor).

c) Të bashkëpunojnë me njësitë baze të qeverisjes vendore për rastet kur prindi nuk e ka certifikatën e lindjes së fëmijës apo vërtetimin e vaksinimeve të tij.

d) Të monitorojnë rastet e kopshteve dhe shkollave që nuk kanë të regjistruar fëmijë romë në kopsht, edhe pse këta fëmijë banojnë në zonat në juridiksion të atyre kopshteve e shkollave.

e) Të monitorojnë punën e kopshteve e shkollave që kanë në varësi kopshte për integrimin e fëmijëve romë.

f) Të sigurojnë përkujdesje të posaçme të psikologut/punonjësit social për fëmijët romë që ndjekin kopshtin.

g) Të shohin me përparësi sigurimin e transportit për fëmijët romë të moshës parashkollore.

2. Drejtuesit e kopshteve dhe drejtuesit e shkollave që kanë në varësi kopshte:

a) Të regjistrojnë me përparësi fëmijët romë në kopshte, sidomos në zonat e banuara nga popullsia romë. Në rastet kur kopshti nuk ka kapacitet për të përmbushur nevojat e bashkësisë përreth tij, t’u jepet përparësi fëmijëve të komunitetit rom.

b) Të bashkëpunojnë me njësitë baze të qeverisjes vendore për të mundësuar që fëmijët romë të përjashtohen nga pagesa e depozitës së garancisë në Tiranë dhe nga pagesat e boreve të prindërve romë në të gjithë vendin.

c) Të krijojnë atmosferë mikpritëse në kopsht për fëmijët romë dhe për prindërit e tyre gjatë procesit të regjistrimit dhe gjatë gjithë kohës që fëmijët romë do të ndjekin kopshtin.

d) Të punojnë, duke aktivizuar edukatorët dhe stafin lehtësues të kopshteve për sensibilizimin dhe edukimin e prindërve të fëmijëve romë mbi rëndësinë e parashkollorit dhe çështje të tjera, si: shëndeti, ushqimi, higjiena etj.

II. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore, kopshtet dhe shkollat që kanë në varësi kopshte.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla